



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-30336/23
Kaçanik, 30.11.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X (dhjetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 30 nëntor 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 27 anëtarë, ndërkaq 7 anëtarë nga LVV e bojkotuan mbledhjen pas aprovimit të pikës së parë, respektivisht gjatë pozicionit të Pyetjeve dhe Kërkesave: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Naim Beça, Bashkim Luma.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Zahir Doda- DA, Sali Malsiu-DSHMS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Xhelal Dema, Bejtulla Dalloshi, Ylber Bajra, Maviqe Murseli, pati edhe zyrtar tjerë të komunës.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 27 anëtarë, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e X (dhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 30 nëntor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 ZK Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore komuna Kaçanik;
3. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 60/01-24386//23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00643-0 ZK Kaçanik në emër të Adnan Vishi për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1 pronë shoqërore komuna Kaçanik;
4. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 60/01-24387/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00544-0 ZK Koxhaj

në emër të Mejdi Xhokli për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00545-0 pronë shoqërore rrugë e pakategorizuar komuna Kaçanik;

5. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik dhe Koxhaj;
6. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik, Duraj-Gabrricë, Doganaj, Sllatinë, Ivajë;
7. Propozim Vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kohë të caktuar për raste të veçanta, kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. a (KEDS);
8. Raporti i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;
9. Kërkesa e MMPHI për Rishqyrtim të Vendimit 01Nr. 06-350/01- 27224/23 për caktimin e Lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Sopicë;
10. Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore;
11. Propozim Vendimi për faljen e tatimit në pronë, për vitin tatimor 2023.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 11 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush vërejtje në Procesverbal, kërkoj t'i paraqitni:

znj. Ardita Rrahmani: Në mbledhjen e kaluar e kam bërë një pyetje lidhur me projektin e rreth rrotullimit, projekt ky i cili veç ka filluar. Pyetja ime nuk është përfshirë në procesverbal. Gjithashtu nuk me është dhënë përgjigje nga drejtorja, kur janë dhënë përgjigjet për pyetjet tjera.

z. Agim Mani: Ne si grup i LVV secili nga ne kemi hasur në gabime të shumta në procesverbal, andaj si grup i LVV nuk e votojmë procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit: Aty ku keni vërejtje konkrete Agim, kërkoj t'i jepni. Nëse nuk i paraqitni vërejtjet, atëherë me vërejtjen e Ardites, Procesverbalin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për 19 votë, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 2 (Raif Kasa dhe Naim Beça) Nuk votuan 6 anëtarë nga LVV. Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IX (nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 31.10.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-27481/23.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Naim Beça: 1. Rruga "Avdurrâhim Shehu" e cila i ka filluar punimet 2 vite me parë dhe nuk ka përfunduar. Ku është problemi i kësaj rruge? Ka pasur me u shtruar trotuari anash dhe muri anësor, asnjëra nuk janë realizuar. A ka me vazhduar ky projekt, apo çka do të bëhet, se qytetarët janë të interesuar të dinë për këtë çështje.

2. Dritat e qytetit: Qytetarët janë shumë të brengosur për dritat e qytetit, se kohëve të fundit ka pasur shtim të qenve endacak. Ka pasur raste kur i kanë sulmuar njerëzit sidomos natën dritat po nevojiten me u mbrojtur prej tyre. Shumica e dritave kanë filluar të prishën dhe kurrfarë intervenimi nuk është marrë në këtë drejtim. Çka u bë me tenderin që është shpallë, a ka dështuar apo çka është në pyetje?

3. Kur do të rregullohet trotuari të sheshi? Aty është shtruar një pjesë me asfalt për rrugë, ndërkaq trotuari anash nuk është bërë. Duhet kuptuar se tani jemi në dimër, është problem qarkullimi i qytetarëve nëpër baltë në atë pjesë.

4. Çështja e punëtorëve të QPS që janë në zyrat e Palestrës sportive, kur ka me iu bërë zgjedhje, se ata nuk janë punëtorë sportiv? Këtë pyetje e kam bërë në mbledhjen e kaluar, por nuk kam marrë përgjigje. Ata punëtorë duhet me i hequr nga palestra sportive dhe me iu bërë zgjidhje të zyrave diku tjetër.

5. Zjarrfikësit e Kaçanikut i kishin kushtet ekstrem të këqija, duke filluar nga kamionët dhe asetet tjera të intervenimit, të cilat mund të shkaktojnë vonesa në intervenim. Duhet të kuptojmë se zjarrfikësit janë si policia dhe asnjë mjet se kanë si duhet. Një intervenim i fundit që ka ndodhur në rrugën kryesore ku pati rast me fatalitet, zjarrfikësit tonë nuk kanë pasur mundësi me intervenuar në formë profesionale si duhet, në mungesë të mjeteve, kështu kanë ardhur zjarrfikësit e Ferizajt me intervenuar për rastin në fjalë dhe e kanë larguar nga rruga personin i cili me pas ka ndërruar jetë. Ku është çështja, kjo është përgjegjësi shumë e madhe për komunën tonë, pavarësisht se kanë me dalë në objekt të ri, pavarësisht se ndoshta kanë me i blerë pajisjet e reja, por tani për tani gjendja e tyre është në ekstrem keq, andaj duhet pasur kujdes këtë çështje.

z. Agim Mani: Nuk e di çfarë kuptimi kanë pyetjet, kur nuk marrin përgjigje, në disa raste pyetjet marrin përgjigje jo adekuate, e jo qysh i kërkojmë ne. Unë vet kam bërë pyetje para 6-7 muajve, e kam përsëritë pyetjen e njëjtë, por nuk kam marrë përgjigje. Me e freskëta është pyetja e mbledhjes së kaluar. U bënë një muaj nga mbledhja kur e kam bërë pyetjen, por nuk kam marrë përgjigje. Nuk e di cila është arsyeja me ngritur pyetje, kur nuk marrim përgjigje nga kryetari as me shkrim as me gojë?

z. Adnan Reka: Në mbledhjen e kaluar e kam bërë një pyetje, keni thënë se nuk ka përgjigje. Pyetja ka qenë: A ka kolegji AAB kontratë me komunën dhe kush ia ka dhënë atë kontratë? Një përgjigje që është dhënë kryesues, Ju keni thënë ka mundësi Kryeministri i Kosovës. Kjo është përgjigje skandaloze. Në procesverbal është kështu dhe ju konsultoni me procesverbalin. 2. Tjetra lidhur me pyetjen, keni thënë që ekzekutivi i komunës përgjigjet se unë nuk jam në ngjarje. Unë po kërkoj nga kryetari me ditur se kush ia ka dhënë kontratën kolegjit AAB dhe kush ia ka dhënë çelësat? Një muaj ditë ka pasur afat dhe nuk është dhënë përgjigje, atëherë ne nuk mund të vazhdojmë kështu, se pyetjen e keni pasur që 1 muaj ditë me shkrim.

Kryesuesi i Kuvendit: E para është shënuar gabim, Kryeministri i Kosovës, ka qenë Albin Kosova. Për të dytën, unë në çdo mbledhje e potencoj se përgjigjet i jep ekzekutivi i komunës në pyetje dhe kërkesa. Përgjigjet i marrim me shkrim, është në obligim me u kthyer përgjigje. Nëse nuk iu ka kthyer përgjigje, merret pyetja përsëri dhe e merr përgjigjen. Praktika nuk ndryshohet me dhënë përgjigje, për shkak se secili pastaj kërkon përgjigje me gojë. Kjo praktikë ka qenë, është dhe do të vazhdojmë tutje.

z. Adnan Reka: Kryesues, ne e kemi një problem këtu, kryetari ose e lëshon mbledhjen me ecur ose të jep përgjigje, se e ka obligim ligjor e jo me na mbajtur ligjërata. Derisa nuk ka përgjigje nuk mundet me vazhduar seanca. Seanca nuk vazhdon pa e marrë përgjigjen nga Kryetari i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk jeni ju që vendosni a me vazhduar seanca apo jo, për këtë çështje vendosë shumica, ndërkaq rendin e seancës e mbajë unë këtu.

z. Agim Mani: Nëse Kryetari i Komunës është i obliguar me dhënë përgjigjen, atëherë Kryetar jepni përgjigjen.

Kryetari i Komunës: Nuk po dua me të dhënë përgjigje. Të gjithëve iu përgjigjem, juve jo. Anën ligjore ka kush e zgjidhë, është Gjykata Adnan. Unë po të pyes ty, a u bllokua kuvendi, pse nuk dha përgjigje ministri ?

znj. Ardita Rrahmani: Kërkoj një pauzë, që të konsultojmë shefat e grupeve të përfaqësuara në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Adnan, ulu e mos e pengoni mbajtjen e seancës, ose mundesh me dalë nga mbledhja. Meqë u krijua kjo situatë, se bashku me shefat e grupeve ishim poshtë, me përjashtim të Agimit që nuk erdhi, kërkuam përgjigje për çështjen e cila u ngritë këtu. DUKMM është duke e përgatitur përgjigjen.

z. Agim Mani: Në emër të LVV kërkoj 5 minuta pauzë për konsultim.

z. Rrustem Zenuni: Je duke e shkelur rregulloren kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit: E di unë rregulloren. Pas 5 minutave, pauzë, konstatoj të vazhdojmë me seancën.

z. Agim Mani: Në emër të LVV jep mendimin tonë. Fillimisht janë ndalë kamerat, kryesuesi nuk ka reaguuar, Për derisa kryetari nuk e jep përgjigjen, ne nuk do të qëndrojmë në seancë. Kështu që ne subjekti politik LVV e bojkotojmë mbledhjen.

Me këtë rast, seancën e bojkotuan 7 anëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje-LVV: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Naim Beça, Bashkim Luma.

Kryesuesi i Kuvendit: Me qëndruar në seancë është mirë, a qëndroni apo jo, ajo është çështje e juaja. Vazhdojmë me mbledhjen të pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave, aty ku mbetëm: A ka pyetje dhe kërkesa tjera?

z. Agim Çaka: Pas kësaj çka ndodhi, nuk kisha dashur me u përsëritur këto çështje, për hir të qytetarëve dhe të kolegëve tonë, sidomos të gjinisë femërorë të cilat janë me të ndjeshme në këto raste. Për çështjen e pyetjeve, e kemi përsëritur në vazhdimësi disa herë që nuk kemi qenë të kënaqur me përgjigjen apo nuk ka pasur përgjigje fare. Është mirë kryesues para seancës me i mbledhë ekzekutivin dhe ditur paraprakisht se a kanë marrë përgjigje anëtarët e KK në pyetjet të cilat janë ngritur në mbledhjen paraprake.

1. Pyetje për kryesuesin e KK: Pasi ishim nëntorin e festave, pse nuk pati seancë solemne, duke marrë parasysh se është një prej festave me të rëndësishme kombëtare dhe me këtë datë 28 nëntori, ndërldhen 3 festa të rëndësishme që shënohen në mbarë Kosovën dhe në mbarë kombin.? Ishte një organizim i zbehtë, ndërkaq në këso raste duhet me pasur një organizim me të mirë, sepse po vijmë në përfundim që ata që e kanë bërë historinë, ata që kanë punuar për këtë ditë me vullnet dhe shumë energji, ndërkaq nga ne nuk kërkohet me shumë, përveç se me u organizuar dhe festuar ato festa.

2. Ndriçimi të varrezat e dëshmorëve, e kam vërejtur se të Varrezat e Veteranëve nuk ka ndriçim, a është brenda projektit, se e ka vërejtur aty kur kalojë sidomos natën, se nuk ka

ndriçim, dhe kjo nuk është mirë për qytetarët që kalojnë atypari dhe për familjarë, se shihet njëfarë diferencimi edhe në bërjen e homazheve si institucion, e kam vërejtur se kjo nuk është mirë se ata janë për të njëjtën çështje dhe për të njëjtin qëllim dhe janë për të njëjtin status aty.

3. Pyetja e tretë, çështja e planit Zhvillimor të komunës, të cilën pyetje po e parashtroj që disa herë. A është gati PZHK, kur do të përfundoj, se po kemi probleme lidhur me pikat të cilat po i trajtojmë, për shkak të PZHK ?

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja e seancës solemne nuk e kemi organizuar, nuk di nëse ka organizuar ndonjë komunë tjetër. Me herët kemi pasur agjenda shtetërore për organizimin e tyre dhe i organizonim, këtë herë nuk kemi pasur ndonjë agjendë. Ka qenë mirë me organizuar seancë solemne, por nuk e di si na ka ikur kjo çështje.

znj. Ardita Rrahmani: Si LDK shprehim shqetësime dhe indinjatë për çështjet të cilat ndodhën pak me herët. Uroj që situata të tilla mos të përsëriten asnjëherë, se nuk na ka hije si KK e asnjërit anëtar të KK, se këto situata po ndikojnë keq edhe të anëtarët e KK (femrat). Kam dy pyetje: 1. Pyetja e parë ka të bëjë me PZHK, të cilën e ngriti edhe parafolësi im. Çka po ndodhë me PZHK, se edhe këtë vit si po shihet nuk do të kemi PZHK.

2 Disa punime që po ndodhin në dalje të ETC dhe të Shtëpia e Shëndetit, çka është duke u bërë aty, a po ndërtohet ndonjë urë, apo çka është duke u bërë? Nëse nuk gaboj, në një seancë apo dy seanca kemi votuar për bartjen e mjeteve diku shumë 45.000€, me arsyetim se nuk ka pasur ofertues për ndërtimin e urave?

znj. Arlinda Rakoci-Raka: E kam një pyetje nga qytetarët e komunës së Kaçaniku se a do të bëhet dekorimi i qytetit në këtë vit?

Kryesuesi i Kuvendit: Një rekapitullim i asaj që ndodhim më herët. Çështja e asaj që ndodhi me herët, askush nuk e dëshiron. Besoj se edhe ata që vepruan ashtu janë penduar, se nuk është kulturë dhe demokratike që sa herë që të flet dikush, na pëlqen apo jo, me e rrahur tavolinën. Kjo mundet me qenë reciproke, sepse ne kemi mendime të ndryshme politike dhe mendojmë ndryshe për çështje të caktuara. Jemi thirrur këtu për me i mbrojtur interesat e qytetarëve, të cilat interesa secili i mbron në mënyrën e vet. Është mirë me respektuar mendimin e secilit, pavarësisht se mund të jetë për dike e pëlqyer, për dike jo, pa dashur me anashkaluar çështjen tjetër që ekzekutivi i komunës e ka obligim ligjor me u përgjigjur në pyetjet dhe kërkesat që ngritën në KK. Kjo praktikë ka vite që aplikohet për përgjigje me shkrim, është mirë me vazhduar kështu dhe përgjigjet të kthehen për çdo seancë për pyetjet që ngritën. Këtë e kam përsëritur që sa herë dhe e përsërisë në vazhdimësi. Por, të insistosh që të ndërpritet seanca, apo veprime për pengimin e zhvillimit të seancës, nuk mendoj se është e drejtë e askujt që të veproj kështu, sepse secili nga ne kemi të drejtat tona dhe secili nga ne kemi të drejtë me diskutuar në mënyrë demokratike ashtu siç duhet diskutuar një kuvend komunal. Nëse vazhdojmë me këto praktika, që secili që diskuton, ndërkaq secili që bënë zhurmë mos me dëgjuar, atëherë ku na dërgon kjo praktikë. Shpresoj dhe besoj të mos ndodhin më praktika të tilla, sepse këto praktika nuk kanë qenë asnjëherë në KK, prej se jam unë këtu, gati 20 vjet. Konstatoj me kaluar në pikën vijuese:

2. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 ZK Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore komuna Kaçanik;

Në mbledhjen e kaluar është marrë vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e PK, MAPL na e ka kthyer vendimin, për faktin se këto ZK fillimisht me u shpall interes publik, pastaj me një vendim tjetër me u bërë këmbimi i pronave. Në zbatim të rekomandimeve të MAPL se kemi adresuar këtë lëndë në KK. E hapi diskutimin: Për diskutim

nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 4 anëtarët nga LDK, nuk votoj Raif Kasa. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për SHFUQIZIMIN e Vendimit të KK 01Nr. 104/02-24408/23 i datës 27.09.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 zona kadastrale Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore Komuna Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 104/02-28122/23.

3. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 60/01-24386//23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00643-0 ZK Kaçanik në emër të Adnan Vishi për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1 pronë shoqërore komuna Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe kjo pikë është e natyrës së njëjtë me pikën 2. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan nuk ka, nuk votoj Raif Kasa. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për SHFUQIZIMIN e Vendimit të KK 01Nr. 60/01-24386/23 i datës 27.09.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 00643-0 zona kadastrale kaçanik në emër të Adnan Vishi për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00644-1 pronë shoqërore komuna Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 104/02-28124/23.

4. Kërkesa e MAPL për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 60/01-24387/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00544-0 ZK Koxhaj në emër të Mejdi Xhokli për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 00545-0 pronë shoqërore rrugë e pakategorizuar komuna Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan nuk ka, nuk votoj Raif Kasa. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për SHFUQIZIMIN e Vendimit të KK 01Nr. 60/02-24387/23 i datës 27.09.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e Parcelës kadastrale 00544-0 Zona kadastrale Koxhaj në emër të Mejdi Xhokli për këmbim me pjesën e Parcelës kadastrale 00545-0 pronë shoqërore rrugë e pakategorizuar Komuna Kaçanik./ Lënda: 01Nr. 104/02-28125/23.

5. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik dhe Koxhaj;

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa është e MAPL që kemi prona që janë me interes publik, që në të ardhmen synojmë me i këmbyer. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për SHPALLEN në interes të përgjithshëm publik, Parcelat kadastrale të pronës së paluajtshme në Zonën kadastrale Kaçanik Lënda: 01Nr. 104/02-30042/23.

6. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik, Duraj-Gabrricë, Doganaj, Sllatinë, Ivajë;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për SHPALLJE në interes publik të parcelave kadastrale në zonat kadastrale Kaçanik, Duraj - Gabrricë, Doganaj, Sllatinë dhe Ivajë/ Lënda: 01Nr. 104/02-30044/23.

7. Propozim Vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kohë të caktuar për raste të veçanta, kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. a (KEDS);

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, kjo pikë është trajtuar edhe me herët në KK, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtoj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 19, pasi Betim Shala doli nga mbledhja. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim në kohë të caktuar për raste të veçanta Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. a. (KEDS), për 15 vjet/ Lënda: 01Nr. 104/ 02-30043/23.

8. Raporti i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje është trajtuar edhe në KPF. Raporti është hartuar nga zyrtarët, mundet të jetë i mangët se drejtoresha është në pushim. E hapi diskutimin: Nëse nuk ka kush me diskutuar, Raporti është sa për informatë, kështu që konstatoj se Kuvendi i komunës

NJOFTOHET

Me Raportin e përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2022/ Lënda: 01Nr.02-060/01-30017/23.

9.Kërkesa e MMPHI për Rishqyrtim të Vendimit 01Nr. 06-350/01- 27224/23 për caktimin e Lokacionit për varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë;

Kryesuesi i Kuvendit: U potencua edhe me herët se mungesa e PZHK po na paraqet problem në procedurat për trajtimin e pronave të caktuara. Duhet PZHK të bëhet drejtor sa me shpejt, se janë disa çështje sikur kjo që nuk presin shumë, pasi lokacioni i varrezave në Doganaj është në përfundim e sipër, andaj duhet trajtojmë këtë çështje me urgjencë. E hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë

VENDIM

Me të cilin, ANULOHET Vendimi i KK 01Nr.06-350/01-27224/23i datës 31.10.2023 për caktimin e lokacionit me destinim për Varrezat e fshatit Doganaj dhe Soponicë, në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë, në numër të parcelës P-70917026-00143-3, me sipërfaqe të përgjithshme prej 01.49.95 ha Zona Kadastrale Doganaj, e evidentuar në pronësi Komuna e Kaçanikut. 01Nr.104/02-30223/23.

10. Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore;

Kryesuesi i Kuvendit: kjo temë është aktuale. Në kuadër të Grupit të grave asambleiste janë zhvilluar aktivitete, është mbajtur edhe një tryezë, me vjen keq që nuk pata mundësi me marrë pjesë se isha me një takim tjetër. Aktiviteti është zhvilluar dhe ka kaluar mirë. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Si kryetare e GGA, po me marrë fjalën lidhur me aktivitetin e organizuar në kuadër të 16 ditë aktivizëm, ka qenë një prej aktiviteteve me të mira të GGA nga themelimi. Kësaj tryezë i kanë kontribuar panelistët ku ka qenë edhe një profesor universitar dhe pjesëmarrës tjerë, ku ka pasur pyetje dhe deklarime të tyre rreth kësaj teme. Dhuna në familje, dhuna në baza gjinore si dhe dhuna ndaj gruas, është shqetësim që përfshinë gjithë globin, ku shifra prej 245 milion grave të dhunuara nga partnerët e tyre qoftë dhunë seksuale, fizike dhe psikike, përfshirë në këtë shifër edhe komunën tonë dhe shtetin tonë fatkeqësisht. Në si GGA e kemi zhvilluar atë tryezë duke dërguar një mesazh në gjithë Republikën e Kosovës, për me treguar unitetin e përkrahjes se individëve që përjetojnë dhunë. Uroj aktivitetet e tilla të mos mungojnë nga ne dhe përkrahja të jetë e madhe institucionale për to.

z. Agim Çaka: Takimi i djeshëm ishte i organizuar mirë, pati panelistë të mirë, pati diskutime të mira. Është mirë që ne si të solidarizohemi kundër këtij fenomeni shqetësues, i cili asnjëherë nuk ka qenë karakteristikë për kombin tonë. Kohëve të fundit ky fenomen ka marrë përmasa të mëdha, dhuna në familje, në shoqëri të cilat po paraqiten edhe në jetën e përditshme, kështu që ne si shoqëri për atë çka mundemi me kontribuar në çfarëdo forme, në mënyrë që të jemi para qytetarëve të japim një frymë të pozitive, sepse dhuna qoftë në rrugë, familje, institucione, pastaj është tema e barazisë gjinore, tema këto që po vijnë dita ditës duke u shtuar, si mbrëmë ishte një ngjarje e rëndë, ajo është jo dhunë në familje, por në shoqëri, e cila manifestohet të gjeneratat e reja. Krejt këto, sipas mendimit tim profesional, janë lufta, pandemia, situata ekonomike, faktorë këta që shtojnë dhunën, shtojnë arsyen për me pasur dhunë. Ne si institucion duhet me qenë të gatshëm me i kontribuar në çfarëdo forme, qoftë përmes takimeve, promovimeve që ky fenomen të jetë sa me pak i shpërfaqur, të ketë sa me pak raste. Kërkesa ime është që të gjitha institucionet relevante që merren me këtë fenomen, të gjejnë bashkëpunim. Të gjithë panelistët flisnin për fushën e vet, por me pasur sukses, duhet bashkëpunimi institucional i gjithë mekanizmave relevantë, që ky fenomen të jetë sa me pak i shpërfaqur.

11. Propozim Vendimi për faljen e tatimit në pronë, për vitin tatimor 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo temë u diskutua edhe me herët, njëherë u dashke me vendosur komunat, pastaj u bë si projektligj, duke kaluar në instanca tjera. Ne si komunë me një buxhet të vogël që 3 vjet pa investime nga qeveria, na dëmton bukur shumë në buxhet. Një analizë me të thukët e jep drejtori, se ka të dhëna me të sakta. Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Ligji i ri i Tatimit në pronë na thotë që kryetarët e komunave me dërguar në KK propozimin për faljen e TP deri në 100€ për vitin 2023. Pasi u zvarritën disa procedura, se ligji ishte në kushtetuese, qytetarët e komunës tonë, gati krejt e kanë paguar barrën tatimore për vitin 2023. Nëse merret ky vendim, mjetet iu rimburosohen për vitin vijues. Nëse merret ky vendim, inkasimi i tatimit në pronë ndikon për 411 mijë euro, apo 80% e mjeteve të inkasuara për një vit tatimor, nga 500 mijë euro. Ju e vlerësoni sesi e merrni vendimin. Për çështjen e faljes së tatimit në pronë, menaxheri i tatimit në pronë, na jep detaje me të sakta.

Kryesuesi i Kuvendit: Falja e Tatimit në Pronë-TP është për të gjithë pa përjashtim deri në shumën 100€, kjo nuk ndikon me tepër të shtresat e pasura, e jo atyre që kanë nevojë me së shumti. E hapi diskutimin:

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Nëse një tatim pagues e ka borgjin 90€, sa mjete i falen?

z. Bahri Selimi: Nëse dikush e ka Tatimin në pronë 90€, i falën 90€, nëse e ka Tatimi në pronë, 130€, i falen 100€, ndërkaq paguan vetëm 30€.

z. Bashkim Krasniqi: Sa e kam kuptuar ligjin e ri, nga viti vijues ata që kanë shtëpinë në vlerë 30,000€, tatimin në pronë e kanë zero. Nëse një familje ka TP 20€ dhe i ka paguar këtë shumë, ndërkaq në vitin tjetër nuk ka tatim në pronë, qysh i rimurësohen ato mjete?

z. Bahri Selimi: Me ligj, nëse vlera e shtëpisë është 70,000€, vlerën e shtëpisë e ulë për 15,000€, dhe e taton për vlerën që mbetet. Për vitin vijues ligji e ka paraparë nga vlera e objektit primar-shtëpisë, ka me u zbritë për 30,000€. Deri në këtë vlerë, nuk paguan TP, fatura iu vjen zero. Është e drejtë me iu kthyer, ndërkaq ne si Zyre e TP nuk e di a kemi me bërë ndonjë ankesë që ai që paguan sivjet TP, në vitin vijues me iu kthyer, se ligji e parasheh rimbursimin.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Tatimi në pronë, a bëhet në bazë të m², apo në bazë të vlerës së shtëpisë?

z. Bahri Selimi: Vlera bëhet në bazë të m² dhe çfarë koeficienti ka, çfarë norme tatimore ka, 10%, 20% varet sa është, minus 30.000€, pastaj nxjerrët shuma e obligimit tatimor. Të vlera tatimore, ne e patëm kundërshtuar me herët në ministri, se u pat ngritë, kështu vlera ka mbetur e lartë, sidomos bizneset janë të prekur nga rritja e vlerës së pronave.

z. Agim Çaka: Nga këndi im, faljen e llogarisë humane, nga mundësitë dhe kapacitetet e secilit, se është mirë me falë. Për qeverinë ndoshta është lehtë me thënë me falë TP, pa e ditur mundësitë dhe kapacitetet. Ne e dimë që buxheti i komunës nuk është i kënaqshëm, e theksuat edhe ju, megjithatë falja e TP ndikon mirë tek qytetarët në këto rrethana që jemi, për shkak të gjendjes së vështirësuar ekonomike, mirëpo kur bëhet krahasimi i faljes se TP për ata që nuk kanë, edhe 10€ me i falë janë mjaftë, kështu që në parim unë jam me falë TP, se e dinë që je duke falë diçka dhe zënë vend tek qytetarët. Me pasur mundësi me i kursyer mjetet që po keqpërdorën në disa projekte, është mirë, ndërkaq unë kisha thënë që çdo vit me bërë falje në bazë të mundësive, por jo me dëmtuar buxhetin në asnjë mënyrë.

znj. Ardita Rrahmani: Ne si LDK desha me treguar se e kemi një qëndrim, drejtori na dha sqarime të nevojshme, megjithatë do ishte mirë me na dhënë informata edhe menaxheri i TP sesa ndikon shuma e faljes në buxhet të komunës, se shuma e mjeteve që falën 411 mijë euro janë bukur shumë mjete, të cilat ndikojnë në realizimin e projekteve kapitale.

z. Xhelal Dema-Menaxher i TP: Falja e TP sipas ligjit të ri është deri 100€. Nëse i keni 10€ borgj, të falet shuma 10€, i keni 20€ borgj, të falen 20€, i keni 100€ borgj, të falen 100€. Nëse i keni 120€ borgj, të falën 100€. Prej ngarkesës totale për vitin 2023 nga 10426 tatim pagues, ngarkesa është 510,632€, ndërsa nën 100€, janë 9491 tatimpagues, ndërkaq mbi 100€ janë 935 tatimpagues, që i bien me u falë mbi 410 mijë euro, 80.58%. Në vitin 2024 falja për banim primar zbritja e vlerën tatimore është për 30,000€. Me këtë zbritja një numër i madh i tatimpaguesve, hiqen nga TP.

Kryesuesi i Kuvendit: Shumë me arsyeshme janë ato që ulët vlera tatimore deri në 30,000€, duhet me shqyrtuar faljen. Bashkim Krasniqi e pati një pyetje me herët, me kërkesën e kryesuesit, e përsëriti pyetjen.

z. Bashkim Krasniqi: Pyetja ime ishte: Meqë shumica e qytetarëve e kanë paguar TP për vitin aktual, për vitin tjetër, ata që e kanë vlerën e shtëpisë nën 30,000€, TP i vjen zero. Në çfarë formë kanë më iu rimbursuar mjetet këtyre tatimpaguesve? Qysh po e shoh unë, nga falja e TP po përfitojnë tatimpaguesit që kanë mundësi me paguar, ndërkaq shumë pak po ndikon të familjet që janë në varfëri të skajshme.

z. Xhelal Dema: Tatimpaguesit ngarkohen me barrën tatimore në bazë të m2. Ai që ka shtëpinë me të vogël, përfiton me pak nga falje, bëhet fjalë vetëm për vitin 2023, në rast se tatimpaguesi ka pagur TP për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese. Në vitin 2024 mundet mos me pasur ngarkesë, por nëse ka në vitin 2025, mbetet shuma e paguar si parapagim.

z. Rrustem Zenuni: Ne qysh me herët jemi përballë me faljen e TP, por ne patëm refuzuar me futur në rend pune atë pikë, për arsye se u kontestonte ligji, pasi nga AKK dhe nga disa komuna iu patën drejtuar Gjykatës kushtetuese për shqyrtim. Pasi kjo pikë është futur në rend pune nga KPF, nga sqarimet që u dhanë nga Zyra e TP, komuna e Kaçanikut do të ketë mungesë të TP për 411 mijë euro, apo 80%. Nga analizat e tona, si shef i grupit, unë kam kuptuar që falja e TP ndikon në investimet kapitale të vitit 2024, p. sh. mungesa e një trotuari, urës, e një salle sportive, e një rruge, ujësjellës, kanalizim, kështu që ne mbi këtë bazë jemi mos me përkrahë faljen e TP. Tani jemi në fund të vitit dhe shumica e tatimpaguesve e kanë paguar TP. Këtu duhet cekur se vjen në shprehje ligji i ri i TP, ku është paraparë rritja e bonusit ose falje për mos vlerësim deri 30,000€. Ne mendojmë se me këtë hyrjen e ligjit të ri në fuqi nga 2024, përfshinë 30,000 subjekte që nuk do të përfshihen fare në TP, sepse e kanë faturën nën 30€. Kjo është edhe një arsye shtesë që subjektet e tatimit në pronë do të jenë përfitues në bazë të ligjit dhe falja e TP do të vjen pak në shprehje, përpos të atyre që kanë faturat me të larta.

z. Agim Çaka: Unë jam i interesuar me ditur me tepër tatimpaguesit që kanë obligim tatimor nën shumën 100€, a janë shumë kjo kategori, me ditur si përqindje a janë shumë këta kategori që nuk kanë pasur mundësi me paguar TP, se nuk po e kam dertin për kategoritë e të pasurve, por jam i interesuar për kategorinë e ulët dhe të mesme. Nëse ka mundësi me iu ndihmuar, me iu ndihmuar këtyre kategorive, përndryshe duhet me pasur kujdese, se unë nuk jam i interesuar me dëmtuar buxhetin duke ua falë borgjin njerëzve të pasur.

z. Xhelal Dema: Nga 9491 tatimpagues, mbi 100€ janë 935 tatimpagues, që i bien me u falë mbi 411 mijë euro, 80.58%. këtu bëhet fjalë për ngarkimin e vitit 2023. Inkasimi e kalon shumën 411.000€, 425,000€ janë të inkasuara deri me tani, por nuk janë krejt ngarkesa të vitit 2023, por janë edhe borgje nga vitet e kaluara.

z. Rrustem Zenuni: Lirimi nga pagesa e TP ndikon në buxhetin e komunës, se që 3 vitet e fundit jemi dëshmitarë se nuk ka asnjë investim në komunën tonë, ndërkaq ne kemi dëgjuar nga mediat dhe deklarime të deputetëve të Kuvendit të Kosovës sidomos nga subjektet opozitare, se qeveria disa komuna si Shtimja, e ka mbështetur për investime kapitale në dy vitet e fundit apo vetëm në këtë vit rreth 21 milion euro.

znj. Ardita Rrahmani: Mos fol për ata të cilët nuk janë në sallë. Do ishte mirë me u fokusuar në pikën e rendit të punës, e jo në deklaratimet e nivelit qendror.

Kryesuesi i Kuvendit: Po të kishim investime nga niveli qendror, ndoshta nuk kishte me ndikuar shumë, por çështja është se që 3 vite nuk e kemi asnjë cent nga niveli qendror, kështu që po duhet me u bazuar në forcat tona.

znj. Ardita Rrahmani: Pajtohem me atë që thoni, por nuk është në rregull me iu drejtuar opozitës kur nuk janë këtu prezentë.

z. Rrustem Zenuni: Ne si komuna duhet të jemi të barabarta. Nëse e bëjë krahasimin unë, dua me ditur pse nuk përfitojmë donacione nga niveli qendror. Unë nuk po iu drejtohem juve, por

qytetarëve se qytetarët duhet me qenë të informuar, që lë të shkon mesazhi të ta se cila është arsyeja që ne nuk mundemi me përkrahur këtë vendim, se shumë projekte mbesin pa realizuar, si çështja e pastrimit të rrugëve, nëse bien borë e rrugët mbesin pa pastruar, duhet ditur arsyet pse nuk janë pastruar rrugët.

Kryesuesi i Kuvendit: Vlera e investimeve nga ministritë në tre vitet e fundit ka qenë e ulët, mos të themi zero investime. Realisht pavarësisht kush e ka pasur pushtetin, kemi përfutur ndonjë projekt, rrugë, trotuar apo ndonjë shkollë. Ne e kemi problemin e shkollës në Doganaj, që nga viti 2019 ka mbetur në gjendje të vështirë, kjo duhet të jetë brengose së për nivelin qendror dhe lokal. Me brengose së është të mësojnë nxënësit në një objekt ku janë shfaqur krimbat, sesa me u falë një shumë simbolike të borgjeve për ata që janë kategori me e ulët në aspektin financiar. Sido që të jetë, ne i respektojmë mendimet e secilit këtu.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Rastet sociale e kanë diçka lirim të tatimi në pronë?

z. Xhelal Dema: Jo, si kategori rastet sociale nuk lirohen nga pagesa e tatimit në pronë.

Kryesuesi i Kuvendit: Për diskutim nuk ka kush tjetër, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë: Rezultati i votimit: Për votoj 1 Raif Kasa, Kundër votuan 17, Abstenim 1 Agim Çaka. Prezentë 19. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës morë këtë:

VENDIM

Për REFUZIMIN E Propozim Vendimit i Kryetarit të Komunës 104/02-30644/23 i datës 24.11.2023 për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023/ Lënda: 01Nr. 104/02-30644/23.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:56. Deri në fund të mbledhjes ishin 19 anëtarë, pasi 7 anëtarë nga LVV: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Naim Beça, Bashkim Luma. i bojkotuan punimet e seancës pas Procesverbalit, respektivisht gjatë pozicionit të Pyetjeve dhe Kërkesave, ndërkaq Betim Shala pas pikës 6 doli nga mbledhja me leje të Kryesuesit të Kuvendit.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu
Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli
Murseli



REGJISTËRI I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

Nga Mbledhja e X (dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2023, mbajtur me 30.11.2023 :

1. Kemal Murseli
2. Brahim Imishti.....
3. Hamide Luma
4. Kadri Krivenjeva
5. Fitore Vishi,.....
6. Rrustem Zenuni,.....
7. Edon Baftiu
8. Selajdin Troni
9. Fatmir Bunjaku
10. Bashkim Krasniqi
11. Florina Lika-Vishi
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....
13. Agim Mani
14. Kadrije Lika-Troni
15. Adnan Reka
16. Naim Beça
17. Raif Kasa
18. Ernesta Krasniqi,.....
19. Bashkim Luma
20. Arta Avdiu
21. Ardita Rrahmani
22. Besnik Salihu
23. Betim Shala,.....
24. Arlinda Rakoci-Raka.....
25. Rabije Sallahi.....
26. Ekrem Livoreka.....
27. Agim Çaka.....



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 20.12.2023

Për: Anëtarët e Kuvendit- **z. Naim Beqa,**
z. Agim Çaka dhe
znj. Arlinda Rakoci-Raka

Lënda: PËRGJIGJE

I nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të japim sqarime zyrtare lidhur me pyetjen/kërkesen tuaj, të parashtruar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, më datë, **30.11.2023**, e cila ndërlidhet me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

z. Naim Beça:

1. Dritat e qytetit: Qytetarët janë shumë të brengosur për dritat e qytetit, se kohëve të fundit ka pasur shtim të qenve endacak. Ka pasur raste kur i kanë sulmuar njerëzit sidomos natën dritat po nevojiten me u mbrojtur prej tyre. Shumica e dritave kanë filluar të prishën dhe kurrfarë intervenimi nuk është marrë në këtë drejtim. Çka u bë me tenderin që është shpallë, a ka dështuar apo çka është në pyetje?

- *Mungesa e kontratës aktive për mirëmbajtjen e ndriçimit publik ka reflektuar edhe në vonesë të intervenimit me kohë në defektet e paraqitura në rrjetet ekzistuese të ndriçimit publik. Duke u nisur nga ky fakt, DSHPE-ja ka inicuar një kërkesë për kontratë emergjente që është kontraktuar në vlerë 6,383.00€ dhe me fillim të këtij muaji është intervenuar në lokacionet më me prioritet dhe janë sanuar defektet në rrjetet ekzistuese. Jemi gjithashtu në dijeni se ka akoma lokacione për intervenim por sapo të kontraktohet kompania për periudhën trevjeçare për mirëmbajtjen e ndriçimit publik do të inervenohet në sanim të defekteve.*

2. Kur do të rregullohet trotuari të sheshi ? Aty është shtruar një pjesë me asfalt për rrugë, ndërkaq trotuari anash nuk është bërë. Duhet kuptuar se tani jemi në dimër, është problem qarkullimi i qytetarëve nëpër baltë në atë pjesë.

- *Kompania e kontraktuar për zhvillimin punimeve të Sheshit të Qytetit ka të kontraktuar edhe rregullimin e trotuarit kështu që edhe ky pozicion krahas pozicioneve tjera të sheshit, do të kryhet shumë shpejt.*

3. Zjarrfikësit e Kaçanikut i kishin kushtet ekstrem të këqija, duke filluar nga kamionët dhe asetet tjera të intervenimit, të cilat mund të shkaktojnë vonesa në intervenim. Duhet të kuptojmë se zjarrfikësit janë si policia dhe asnjë mjet se kanë si duhet. Një intervenim i fundit që ka ndodhur në rrugën kryesore ku pati rast me fatalitet, zjarrfikësit tonë nuk kanë pasur mundësi të intervenuar në formë profesionale si duhet, në mungesë të mjeteve, kështu kanë ardhur zjarrfikësit e Ferizajt me intervenuar për rastin në fjalë dhe e kanë larguar nga rruga personin i cili me pas ka ndërruar jetë. Ku është çështja, kjo është përgjegjësi shumë e madhe për komunën tonë, pavarësisht se kanë me dalë në objekt të ri, pavarësisht se ndoshta kanë me i blerë pajisjet e reja, por tani për tani gjendja e tyre është në ekstrem keq, andaj duhet pasur kujdes këtë çështje.

- *Funksionimi i Shërbimi i Zjarrfikësave dhe Shpëtimit, ngjashëm si në të gjitha komunat e Kosovës, është i ndërlidhur me AME-në (Agjensioni për Menaxhimin e Emergjencave). Komuna, krahas pagave, mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale, nga mjetet buxhetore për investime kapitale në vitet 2022-2023 është duke investuar në ndërtimin e objektivit të ri për zjarrfikësat me standarde dhe kushte jashtëzakonisht të mira. Kurse rreth makinerisë dhe rekrutimit të stafit, kjo është kompetencë e AME-së.*

z. Agim Çaka:

Ndriçimi të varrezat e dëshmorëve, e kam vërejtur se të Varrezat e Veteranëve nuk ka ndriçim, a është brenda projektit, se e ka vërejtur aty kur kalojë sidomos natën, se nuk ka ndriçim, dhe kjo nuk është mirë për qytetarët që kalojnë atypari dhe për familjarë, se shihet njëfarë diferencimi edhe në bërjen e homazheve si institucion, e kam vërejtur se kjo nuk është mirë se ata janë për të njëjtën çështje dhe për të njëjtin qëllim dhe janë për të njëjtin status aty.

- *Rregullimi i ndriçimit publik në pjesën e lokacionit të Varrezave të Vetranëve të luftës së UÇK-së do të shqyrtohen të implementohet përmes kontratës “Rregullimi i ndriçimit publik” projekt i koduar për vitin 2024.*

znj. Arlinda Rakoci-Raka: E kam një pyetje nga qytetarët e komunës së Kaçaniku se a do të bëhet dekorimi i qytetit në këtë vit?

- *Projektit për dekorimin e qytetit për festat e fundvitit është duke u implementuar në bulevardin “Ismajl Raka” ku do të dekorohet shetitorja e dytë përgjatë bulevardit.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

Ramadush Osmani

Drejtor i DSHPE-s

Makfire Malsiu

From: Qamil Stagova
Sent: Wednesday, December 27, 2023 10:47 AM
To: Makfire Malsiu
Subject: RE: Pergjigje
Attachments: Përgjigje per kuvend-Nentor 2023.docx

From: Makfire Malsiu <Makfire.Malsiu@rks-gov.net>
Sent: 27 December 2023 10:24
To: Qamil Stagova <qamil.stagova@rks-gov.net>
Subject: FW: Pergjigje

Nuk I ke bashkangjitur pergjigjet

From: Qamil Stagova <qamil.stagova@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, December 27, 2023 10:22 AM
To: Makfire Malsiu <Makfire.Malsiu@rks-gov.net>; Mavije Murseli <mavije.murseli@rks-gov.net>
Subject: Pergjigje

Pershendetje. Ne attach I keni pergjigjet ne lidhje me pyetjet e parashtruara ne Mbledhjen e Kuvendit ne Muajin Nentor.

Jufaleminderit per bashkepunimin



Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Kaçanik, 27.12.2023.

Për: z. Naim Beça, Këshilltar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

Z. Naim Beça, Këshilltar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut në Mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të datës 30.11.2023 ka parashtruar pyetjen:

A do te përfundojë Projekti I Rregullimit të Rrugës "Avdurrahim Shehu"?

- Projekti është I përfunduar, punët që mund te kene mbetë pa u përfunduar sikurse jane përfundimi I trotuarit dhe zhvendosja e ndonjë shtylle duhet te kryhen me projekt të ri.

Per: Z. Agim Mani, z.Agim Çaka, zn Ardita Rrahmani

Z. Agim Mani, z.Agim Çaka dhe zn. Ardita Rrahmani kanë pyete se ku ka mbriri çështja e hartimit te PZHK-se?

- Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM), I cili I paraprin PZHK-se janë dorëzuar në MMPHI ne janar te vitit 2023. Ministria ia ka kthyer Komunës për përmirësimin e disa vërejtjeve. Komuna ka dhene përgjigje per verejtjet dhe VSM-ne e ka dorëzuar ne MMPHI me 22.8.2023. Edhepse Ministria eshte e obliguar qe ten a jep pergjigje ne afatin prej nje muaji, atë ende nuk e kemi marre. Pa e marre Pelqimin e MMPHI-se se VSM-ja eshte ne rregull, ata nuk e pranojne fare PZHK-ne. Kemi mbetur ne pritje, edhepse edhe PZHK-në e kemi pergatitur, ka mbi 2 muaj.

Ju faleminderit për bashkëpunimin...

Drejtori i DUKMM-së
Qamil Stagova
